

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5604  
E mërkurë, 17 tetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Limaj zotohet se do të jetë zëdhënës i prodhuesve vendorë

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**NJË TAKIM I PAZAKONTË DIPLOMATIK QË BËRI JEHONË BOTËRORE** F. 11

Bashkim RRAHMANI

**BAHTIRI: PALA SERBE PO PENGON PËRURIMIN E URËS MBI LUMIN IBËR** F. 2

**HOTI NË BRUKSEL: IDETË PËR KORRIGJIMIN E KUFIJVE, TË RREZIKSHME PËR PAQEN** F. 7

### EKONOMI

**'PËRPLASJE' NË KOMISIONIN PËR ZHVILLIM EKONOMIK PËR LIGJIN PËR AUTOMJETE**

F. 8

**PREZANTOHET LOGOJA E AGJENCISË SË STANDARDIZIMIT** F. 8

### KULTURË

**MARIGONA KRASNIQI SJELL ROMANIN 'ZËRI I MBYTUR I GRUAS'** F. 13



### SPORT

**DERBI KUQEZI I TAKON DRENICËS. 89-shi, BINDËS NDAJ LIRISË** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", MEMLI KRASNIQI | FAQE 4-5

## Opozita nuk e ka seriozisht kërkesën për zgjedhje

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, e ka quajtur joserioze kërkesën e partive opozitare për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se sa i përket kësaj opozite koalicioni qeverisës do ta çojë mandatin deri në fund.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka vlerësuar se kërkesa për zgjedhje ka të bëjë më shumë me problemet brenda partive të opozitës. Sidoqoftë, ai ka bërë me dije se as bojkoti opozitar në Kuvend nuk do të reflektojë në funksionimin e koalicionit qeverisës sepse, sipas Krasniqit, Qeveria është duke e bërë punën e vet dhe ka stabilitet. Ai ka thënë se është papërgjegjësi e skajshme politike që cilido deputet i opozitës apo parti opozitare të abstenojë apo të refuzojë të marrë pjesë në çështjet që ndërlidhen me fazën finale të dialogut me Serbinë, integrimin evropian, zbatimin e MSA-së, liberalizimin e vizave dhe themelimin e ushtrisë

## Haradinaj: Ushtria bëhet pas 20 nëntorit



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se formimi i ushtrisë do të ndodhë në fund të muajit të ardhshëm. Ai ka deklaruar se është planifikuar që leximi i dytë i projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së

Kosovës (FSK) në ushtri të vijë pas 20 nëntorit në Kuvend. Haradinaj ka treguar se Kosova është e interesuar që leximi i dytë i këtyre projektligjeve të ndodhë pas votimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol | FAQE 3

## MSA-ja zbatohet vetëm 12 për qind



Komunat e Kosovës kanë përbushur 67 për qind të obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), por jo edhe niveli kombëtar, i cili deri më tash ka përbushur vetëm 12 për qind të obligimeve | FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Princi i Monakos për herë të parë në Tiranë

TIRANË, 16 TETOR - Princi i Monakos, Alberti II, është pritur me ceremoni shtetërore në vizitën e parë të një monarku të Principatës, nga presidenti i Republikës, Ilir Meta. Albert II po zhvillon një vizitë shtetërore në Shqipëri.

Pas ceremonive të mirëseardhjes dhe ekzekutimit të himneve të

të dy vendeve, presidenti Meta dhe Princi Albert II zhvilluan një takim kokë me kokë dhe më pas kryesuan takimin e zgjeruar midis dy delegacioneve zyrtare.

Presidenti Meta vlerësoi vizitën e Princit Albert II në Shqipëri dhe nënvizoi se në këta shtatë vjet marrëdhëniesh diplo-

matike, bashkëpunimi midis Republikës së Shqipërisë dhe Principatës së Monakos është zhvilluar në mënyrë shumë pozitive. "Vizita e Princit Albert II është shprehje e qartë e dëshirës dhe vullnetit të përbashkët për t'i nxitur e zhvilluar më tej këto marrëdhënie", nënvizoi presidenti Meta.



Çështja e hapjes së urës mbi lumin Ibër ishte temë diskutimi në mes të kryetarit të Mitrovicës dhe shefit të UNMIK-ut në Kosovë

## Bahtiri: Pala serbe po pengon përrurimin e urës mbi lumin Ibër

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, gjatë takimit me shefin e UNMIK-ut në Kosovë, Zahir Tanin, ka bërë me dije se pala serbe është duke penguar përrurimin e urës mbi lumin Ibër, pavarësisht që, sipas tij, interesimi i qytetarëve të të gjitha përkatësive etnike të Të dyja komunave është që kjo urë të hapet sa më parë

### "Epoka e re"

MITROVICË, 16 TETOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të martën në takim shefin e UNMIK-ut për Kosovë, Zahir Tanin, me të cilin ka biseduar për situatën e sigurisë në këtë komunë, me theks të veçantë për urën kryesore mbi lumin Ibër. Kryetari Bahtiri fillimisht E ka falënderuar delegacionin e UNMIK-ut për interesimin e tyre për Mitrovicën dhe për bashkëpunimin e deritashëm të suksesshëm. Ai u tha mysafirëve se që nga ardhja në krye të Komunës së Mitrovicës para pesë vjetësh ka punuar me përkushtim të madh dhe angazhim të pandërprerë për ta stabilizuar gjendjen e përgjithshme në Mitrovicë, duke qenë i vetëdijshëm se pa stabilitet dhe qetësi nuk ka zhvillim ekonomik, pasi investitorët nuk investojnë aty ku nuk ka paqe dhe siguri. "Falë këtij angazhimi por, para së gjithash, falë angazhimit

dhe vetëdijesimit të qytetarëve të të gjitha përkatësive etnike, kemi arritur që Mitrovicën ta bëjmë një qytet stabil dhe ndër më të sigurit në vend. Kjo shihet edhe nga rënia e madhe e të gjitha incidenteve, posaçërisht të atyre ndëretnike, ku gjatë pesë vjetëve të fundit janë shënuar vetëm rreth tetë incidente ndëretnike serioze", ka thënë Bahtiri.

Sa i përket situatës lidhur me urën kryesore mbi lumin Ibër, kryetari Bahtiri u tha mysafirëve se në vitin 2014 në Bruksel kanë filluar negociatat për hapjen e urës për lëvizje dhe qarkullim të lirë të njerëzve dhe të automjeteve. Ai në vazhdim ka bërë me dije se gjatë bisedave janë mbështetur pothuajse të gjitha kërkesat e palës serbe që kishin të bënin me hapjen e urës, ndërkohë që Bashkësia Evropiane ka financuar një projekt për rivitalizimin e urës, në mënyrë që më pas ajo të jetë e lirë për lëvizje dhe qarkullim të njerëzve dhe të automjeteve, projekt ky që ka përfunduar në tërësi



dhe ura tani është e gatshme për përrurim. "Fatkeqësisht, është pala serbe ajo që po e pengon përrurimin e urës, edhe përkundër interesimit dhe kërkesës së qytetarëve të të gjitha përkatësive etnike dhe të të dyja komunave që ajo të hapet sa më parë. Kjo është e papranueshme dhe nuk do të duhet të ndodhë", ka thënë Bahtiri. Ai u ka thënë përfaqësuesve të UNMIK-ut se Bashkësia Ndërkombëtare nuk duhet të tolerojë më sjelljet e këtilla të kryetarit të komunës veriore, Goran Rakiq, pasi nuk ka as më të voglin arsye që ai të nxjerrë pengesa. "Unë

jam i përkushtuar dhe i vendosur që hapjen e urës ta bëjmë me marrëveshje dhe në bashkëpunim me kryetarin e komunës veriore, Goran Rakiq, sepse kjo është mënyra më e mirë dhe më e duhura për zgjidhjen e kësaj çështje, e cila është në interes vital të të gjithë qytetarëve. Por, nëse do të vazhdojë ende sjellja refuzuese e kryetarit Rakiq dhe mosreagimi i ndërkombëtarëve, atëherë organet e Republikës së Kosovës duhet të funksionojnë dhe ta kryejnë detyrën e tyre për hapjen e urës. Çështja e hapjes së urës dhe në asnjë mënyrë nuk bën të ndërlihet me procesin e dialogut ndër-

mjet Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa sa iu përket zhvillimeve në vend dhe dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, kryetari Bahtiri ka thënë se është e papranueshme për Kosovën dhe qytetarët e saj që të bisedohet për ndryshimin apo shkëmbimin e territoreve. Ndërkaq shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, ka thënë se bashkësia ndërkombëtare është e interesuar për normalizimin e plotë të raporteve ndërmjet dy palëve dhe se marrëveshjet e arritura deri më tani duhet të zbatohen nga të gjithë.

## Bushati: Paqja në Ballkan, e rrezikuar nga konfliktet

TIRANË, 16 TETOR - Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati gjatë konferencës për 60-vjetorin e Shqipërisë në UNESCO kërkoi që Ballkani t'i rikthehet dialogut dhe të shmangen konfliktet. Rajoni rrezikohet nga tkurrjet nacionaliste dhe gjuha e urrejtjes. "Do të ishte iluzive nëse do t'i merrim gjërat të mirëqena. Retorika populiste në rritje edhe në shoqëritë e zhvilluara, banalizimi i gjuhës së urrejtjes dhe përçarjes, presioni ndaj multi-

lateralizmit dhe tendencat për tkurrje nacionale, na thërrasin për vigjilencë të shtuar dhe imponojnë nevojën për një fokus të përtërirë, më të qartë, më kërkues dhe për bashkëpunim më efikas. Angazhimi, vullneti, aftësitë dhe shkathësitë e brezit të ri do të jenë vendimtarë si për Shqipërinë dhe rrugëtimin tonë evropian, por edhe për të ndër-tuar një rajon që jeton më së fundmi në paqe dhe pros-



peritet", tha Bushati. Ai këmbënguli për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare si një nga themelet e stabilitetit në rajon. "Kemi mbështetur dhe do të vijojmë ta mbështesim pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë në UNESCO, si një investim i një-mendte për qytetarët e Kosovës, por edhe për forcimin e bashkëpunimit rajonal", tha Bushati.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Haradinaj: Ushtria bëhet pas 20 nëntorit



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se formimi i ushtrisë do të ndodhë në fund të muajit të ardhshëm. Ai ka deklaruar se është planifikuar që leximi i dytë i projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri të vijë pas 20 nëntorit në Kuvend. Haradinaj ka treguar se Kosova është e interesuar që leximi i dytë i këtyre projektligjeve të ndodhë pas votimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol

Interpol dhe liberalizmi i vizave. Ai edhe një herë ka deklaruar se nuk shqetësohet shumë për rrëzimin e Qeverisë. Madje, Haradinaj ka thënë se, siç po duket, do ta çojë mandatin e vet të kryeministrit deri në fund. "Kur të vendosë Kuvendi ta rrëzojë Qeverinë, e rrëzon. Unë vazhdoj të punoj për atë që jam në punë. Nuk i marr shumë afër zemrës këto diskutime", ka thënë ai.

Kreu i ekzekutivit ka deklaruar se lirimi nga detyra e ish-ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, nuk do të ndikojë në procesin e liberalizimit të vizave. "Lirimi prej detyre i ministrit Gashi dhe propozimi për emërimin e ri vjen nga partia e tij, AKR-ja. Mendoj se nuk është ndonjë tronditje në proces të liberalizimit", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj i ka bërë thirrje kryetarit të Komunitetit të Mitrovicës, Agim Bahtiri, që të ketë kujdes në veprimet e tij për hapjen e urës mbi lumin Ibër. Ai ka thënë se ura duhet të hapet në të dyja anët dhe se nuk duhet të ndodhë situata kur në jug ka ndonjë koncert e festohet, kurse në veri vendoset barrikada.

## Qeveria e Kosovës krijon komision për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm

Në mbledhjen e së martës, Qeveria e Kosovës ka krijuar një komision ndër-institucional i cili ka për qëllim të ndihmojë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Zyra e kryeministrit do të ofrojë përkrahje administrative për punën e Komisionit, i cili do të analizojë, rekomandojë dhe trajtojë të gjitha çështjet që ndërlidhen me ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar edhe Strategjinë Shtetërore Kundër Narkotikëve dhe Planin e Veprimit 2018-2022.

Qeveria ka miratuar edhe dy projektligje: Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomik Social dhe Projektligjin për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve të Kosovës. Në këtë mbledhje Qeveria ka miratuar edhe vendimin për t'i rekomand-

uar presidentit të Republikës së Kosovës që ta autorizojë Ministrinë e Financave për nënshkrim të marrëveshjes së kreditit me "Raiffeisen Bank International", për financimin e projektit të skemës për furnizim me ujë në Komunën e Ferizajt si dhe është aprovuar në parim nisma për lidhjen e marrëveshjeve të sigurimeve sociale me Qeverinë e Republikës së Kroacisë dhe me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për plotësimin-ndryshimin e vendimit të Qeverisë për propozimin e emërimit të kryesuesit të Bordit të Rregullatorit për Energji. Me plotësim-ndryshimin e vendimit, Qeveria i propozon Kuvendit këta kandidatë: Fadil Ismaili, Petrit Pepaj, Përparim Kabashi, Bekim Jakupi.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË 16 TETOR** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka treguar se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të ndodhë pas 20 nëntorit. Ai ka deklaruar se Kosovës i konvenon që leximi i dytë i projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri të ndodhë pas mbledhjes së Interpolit, ku me këtë datë pritet të votohet për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. "Kam menduar se kjo pako e projektligjeve të vijë në diskutim pas 20 nëntorit. Ashtu e kemi pasur një orientim kohor.

Leximi i parë ka ardhur më herët, kurse leximi i dytë do të jetë pas 20 nëntorit. Si Kosovë na konvenon që leximi i dytë të jetë pas 20 nëntorit, sepse me këtë datë është mbledhja e Interpolit dhe ne dëshirojmë të mbesim të fokusuar në agjendën tonë të anëtarësimin të Kosovës në Interpol", ka thënë Haradinaj në konferencën me gazetarë, pas mbledhjes së Qeverisë. Ai ka vlerësuar se nuk ka arsye për shqetësim sa i përket çështjes së financave për transformimin e FSK-së. Sipas kryeministrit Haradinaj, përveç formimit të ushtrisë, Kosova gjendet edhe para dy sfidave shumë të rëndësishme, anëtarësimi në

## Kryeprokurori Syla kërkon që lëndët e vjetra të trajtohen me prioritet

**MITROVICË, 16 TETOR (ER)** - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Shyqri Syla, ka mbajtur të martën takim me drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në veri të Mitrovicës, Nenad Gjuriq, me zëvendës-drejtorin Besim Hoti si dhe me shefat e hetimeve të Stacioneve Policore Mitrovicë - Veriu, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq dhe të trafikut regional në veri. Në takim

është diskutuar bashkëpunimi në mes të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës dhe Policisë Rajonale të Mitrovicës në veri, me ç'rast është konstatuar se ekziston një bashkëpunim i shkëlqyeshëm mes tyre dhe u pajtuan që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim të luftimit të dukurive negative në regionin të cilin e mbulon kjo prokurori. Po ashtu, temë e rëndë-

sishme e takimit ka qenë diskutimi për lëndët e vjetra nëpër stacione policore, me ç'rast kryeprokurori Syla ka kërkuar që këto lëndë të trajtohen me prioritet nëpër stacionet policore që mbulon kjo drejtori. Gjatë takimit të lartcekurit u pajtuan që çdo muajt të ketë takime të rregullta në mes të kryeprokurorit Syla me drejtuesit e Policisë së Rajonit të Mitrovicës në veri.





Flet për "Epokën e re", Memli Krasniqi

# Opozita nuk e ka seriozis

- Sa i përket kësaj opozite, Qeveria do ta çojë mandatin deri në fund



Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, e ka quajtur joserioze kërkesën e partive opozitare për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se sa i përket kësaj opozite koalicioni qeverisës do ta çojë mandatin deri në fund. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka vlerësuar se kërkesa për zgjedhje ka të bëjë më shumë me problemet brenda partive të opozitës. Sidoqoftë, ai ka bërë me dije se as bojkoti opozitar në Kuvend nuk do të reflektojë në funksionimin e koalicionit qeverisës sepse, sipas Krasniqit, Qeveria është duke e bërë punën e vet dhe ka stabilitet. Ai ka thënë se është papërgjegjësi e skajshme politike që cilido deputet i opozitës apo parti opozitare të abstenojë apo të refuzojë të marrë pjesë në çështjet që ndërliken me fazën finale të dialogut me Serbinë, integrimin evropian, zbatimin e MSA-së, liberalizimin e vizave dhe themelimin e ushtrisë

Kuvendit të Kosovës në komisionin e përbashkët BE-Kosovë për MSA-në, janë të limituara. Sidoqoftë, bazuar edhe në një rezolutë të miratuar në Kuvendin e Kosovës në baza të rregullta, është kërkuar prej nesh që të komunikojmë me Qeverinë për të parë se në çfarë faze janë zbatimet dhe obligimet. Ne nuk mund t'i detyrojmë përfaqësuesit e Qeverisë që t'i kryejnë detyrat e tyre më shpejt sesa që ata janë duke i kryer. Kemi interes të përbashkët që të kryhen detyrat në një periudhë sa më shpejt që të jetë e mundur.

vendosur ta bëjnë një lojë të tillë politike por, siç u pa edhe gjatë kësaj jave, ata nuk mund të bllokojnë Kuvendin sepse Kuvendi do ta vazhdojë punën e vet. Nevojitet ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare me 2/3 e votave të deputetëve. Ata mund ta pengojnë siç e kanë penguar për muaj të tërë ratifikimin e disa marrëveshjeve me BE-në. Shpresoj se në pamundësi për ta penguar punën e Kuvendit, ata do t'i thërrasin mendjes dhe do të kthehen aty ku e kanë vendin, për çka i kanë obliguar qytetarët e Kosovës me votën e tyre, pra në Kuvendin e Kosovës në seanca, sepse në komisione marrin pjesë. Besoj se së shpejti do të kthehen në punimet e seancës dhe bojkoti i opozitës nuk do të zgjasë më shumë se deri të enjten.

"Epoka e re": Pse mendoni se opozita do ta ndërpresë bojkotin?  
Krasniqi: Sepse nuk kanë asnjë arsye që ta marrin pagën e deputetit dhe të mos e kryejnë punën e deputetit. Kjo është hipokrizi nëse do të vazhdonte për një periudhë më të gjatë sesa

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 TETOR - "Epoka e re": Z. Krasniqi, të martën është raportuar se MSA-ja ka arritur të zbatohet vetëm 12 për qind në nivelin qendror. Cilat mendoni se janë shkaqet e përqindjes së ulët të zbatimit të kësaj marrëveshje të rëndësishme?

Krasniqi: Edhe ne si Komision kemi shprehur shqetësimin tonë për mospërmbushjen në nivel të

kënaqshëm të obligimeve që i ka Kosova karshi marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Kemi diskutuar me përfaqësuesit e Qeverisë për këtë dhe kemi marrë zotimin e tyre se në tremujorin e katërt të vitit 2018 për obligimet që varen drejtpërdrejt prej tyre dhe dikastereve qeveritare do të shtohet dinamika e punës në mënyrë që për qindja e realizimit të detyrave të jetë më e madhe. Nuk mund të them me saktësi se është për qindja e zbatimit 12, 25 apo 40 për qind, sepse ata që merren në

baza ditore, me obligimet që dalin nga MSA-ja, mund të kenë informacione më të sakta. Mirëpo ka hapa të mjaftueshëm të cilët duhet të bëhen shpejt për të arritur nivele të pranueshme të realizimit të obligimeve tona për këtë marrëveshje.

"Epoka e re": Çfarë do të bëni ju si komision dhe si deputet që të arrihet niveli i kënaqshëm i zbatimit të MSA-së?

Krasniqi: Kompetencat e komisionit, përkatësisht të delegacionit të



# ht kërkesën për zgjedhje

kaq. Qëllimi i tyre për ta bllokuar Kuvendin ka dështuar. Kuvendi po vazhdon punën, ka miratuar projektligje, raporte, ka bërë zgjedhjen e anëtarëve të bordeve ashtu siç parashihet me ligjet e caktuara. Puna e Kuvendit do të vazhdojë edhe të enjten në seancën e re. Kështu që, më mirë do të ishte që opozita të vijë dhe t'i ballafaqojmë argumentet për ato pika që nuk kemi pajtueshmëri, por edhe të japin mbështetje për ato pika që kemi pajtueshmëri.

**"Epoka e re":** Rrjedhimisht nuk do të pengohen proceset nëpër të cilat po kalon vendi, siç janë dialogu, ushtria, liberalizimi?

**Krasniqi:** Për çështjet që janë me rëndësi nacionale besoj se përgjegjësia është e përbashkët, pavarësisht se përgjegjësia gjithmonë është më e madhe e koalicionit qeverisës dhe atyre që e kanë shumicën parlamentare. Kjo pa dyshim se është edhe përgjegjësi e opozitës. Çështjet që ndërlidhen me fazën finale të dialogut me Serbinë, integrimin evropian, zbatimin e MSA-së, liberalizimin e vizave, themelimin e ushtrisë dhe çështje të tjera janë përgjegjësi të skajshme politike që cילו deputet i opozitës apo parti opozitare të abstenojë apo të refuzojë të marrë pjesë. Jo për arsye se këto procese bllokohen, por për arsye se obligimi ynë karshi qytetarëve për t'i realizuar këto ka qenë uniformë. Të gjitha këto parti që jemi të përfaqësuar në Kuvend kemi deklaruar se do të marrin përgjegjësi nëse na jepet mundësia. Puna jonë është në Kuvendin e Kosovës qoftë kur

kemi pajtueshmëri, qoftë kur nuk kemi pajtueshmëri. Është e kuptueshme që në çaste të caktuara edhe bojkoti mund të jetë pjesë e veprimtarisë politike, por për çështje të rëndësishme nacionale nuk besoj se ka kurrfarë arsytimi që të bojkotohet pjesëmarrja në seancat e Kuvendit. Këtu po flas për proceset që i përmenda më lart.

**"Epoka e re":** Duke pasur parasysh situatën aktuale, sa ka gjasa të arrihet konsensusi për tema kombëtare, përkatësisht për dialogun me Serbinë?

**Krasniqi:** Nuk pres të kemi konsensus të plotë, sepse qëndrimi i Vetëvendosjes është refuzues në tërësi sa i përket procesit të dialogut. Në këtë kuadër konsensusi do të nënkuptonte pajtueshmërinë e të gjithëve. Por, shpresoj të arrihet një lloj pajtueshmëri e gjerë brenda skenës politike nga pozita dhe opozita për disa nga pikat kryesore të cilat duhet të jenë parime themelore dhe udhëzuese në procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë kuadër ne si PDK jemi të vetmit që për një kohë disamujore kemi diskutuar dhe i kemi ftuar në takime partitë politike nga pozita dhe opozita, por edhe kemi dorëzuar një draftplatformë konkrete me çështjet për të cilat duhet të arrijmë një pajtueshmëri para se të marrë dinamikë procesi i fazës finale të dialogut me Serbinë. Kjo draftplatformë parasheh që nga parimet themelore deri te vijat e kuqe të cilat ndërlidhen me pacenueshmërinë e sovranitetit, shtetësisë, integritetit territorial, me papranueshmërinë e krijimit

të Asociacionit me kompetenca ekzekutive dhe pikat e tjera që janë të panegociueshme për Kosovën. Deri tash kemi pasur një pozicion refuzues nga LDK-ja dhe Vetëvendosja derisa PSD-ja ka propozuar një draftrezolutë në Kuvend për të cilën kam thënë, edhe gjatë seancave, se mund të jetë një bazë për të diskutuar, për të plotësuar dhe për ta bërë ndoshta një rezolutë të përbashkët të Kuvendit që do të ishte një udhëzues konkret për formën se si duhet të vazhdojë dialogu me Serbinë.

**"Epoka e re":** Z. Krasniqi, si e komentoni funksionimin e mëtutjeshëm të koalicionit qeverisës? Do të jetë sfidues vazhdimi i kësaj Qeverie me këta numra dhe me bojkotin opozitar?

**Krasniqi:** Nuk shoh asnjë lloj problemi nga bojkoti i LDK-së dhe Vetëvendosjes sepse puna në Kuvend po vazhdon dhe ligjet po miratohen. Por këtë bojkot e shoh si cenim të debatit demokratik sepse Kuvendi ekziston për t'i ballafaquar argumentet, për t'i ballafaquar qëndrimet që mund të mos jenë të njëjta dhe për të dhënë alternativa qoftë nga pozita, qoftë nga opozita. Në këtë legjislaturë ka pasur shumë raste ku edhe iniciativat e opozitës kanë marrë mbështetjen e koalicionit qeverisës. Nuk ka një ndarje kirurgjike ndërmjet qëndrimeve të pozitës dhe opozitës. Ka shumë çështje ku ne kemi pika të përbashkëta dhe Kuvendi do të duhej të ishte arena e diskutimeve dhe e kompromiseve. Në këtë kuadër kjo nuk do të reflektojë te funksionimi i koalicionit

qeverisës sepse Qeveria është duke e bërë punën e vet, ka stabilitetin dhe sa i përket kësaj opozite, Qeveria do ta përfundojë mandatin e vet.

**"Epoka e re":** Por kjo opozitë po insiston në zgjedhje, madje ka paralajmëruar edhe rrëzimin e Qeverisë.

**Krasniqi:** Sa i përket kësaj opozite, Qeveria do ta çojë mandatin deri në fund. Diskutimet dhe kërkesat për zgjedhje janë legjitime, por opozita absolutisht nuk e ka seriozisht kërkesën për zgjedhje. Asnjë prej partive opozitare nuk janë të gatshme për zgjedhje. Sikur të kërkohehin zgjedhjet me të vërtetë askush nuk i ndalon që ta nisin mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë dhe për këtë u duhen vetëm 40 vota. Por, ata nuk e kanë guximin ta bëjnë një gjë të tillë. Në fakt, LDK-ja dhe Vetëvendosja, që flasin më së shumti për këtë punë, asnjë nënshkrim nuk e kanë dhënë për këtë iniciativë, kurse PSD-ja u ka ofruar publikisht në seancë 12 nënshkrime për rrëzimin e qeverisë. Kjo është një lojë politike e cila po bëhet për pozicionime edhe brenda partive sepse kanë probleme të brendshme partitë opozitare, veçanërisht LDK-ja, me konkurrencën e brendshme për pozitën e kryetarit në zgjedhjet e ardhshme. Kjo është çështje e tyre e brendshme por, nëse vërtet dëshirojnë zgjedhje, le të urdhërojnë dhe të tregojnë që e kanë seriozisht, duke e iniciuar mocionin e mosbesimit, pastaj do të shohim nëse është e vërtetë apo një manipulim i opinionit publik.

## Hoxhaj: Regjistrimi i popullsisë në 2021-n, projekt madhor për vendin

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka marrë pjesë të martën në konferencën me donatorë të organizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës "Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë - 2021".

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se statistikat zyrtare dhe përdorimi i tyre në institucionet vendimmarrëse në Republikën e Kosovës mundësojnë zhvillimin e politikave të qëndrueshme, ndërsa sistemi statistikor i Kosovës është një ndër sistemet më të rëndësishme të vendit në kuadër të të cilit Qeveria merr bazën për hartimin e politikave për vendin, njëkohësisht janë referencë për donatorët e huaj që të investojnë në Kosovë.

Duke folur për regjistrimin e dytë të popullsisë që do të ndodhë në vitin 2021, zëvendëskryeministri Hoxhaj

ka theksuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës që ky proces të shtrihet në gjithë territorin e vendit. Ai ka ftuar donatorët ta mbështesin këtë projekt madhor, pasi mbështetja për këtë projekt është mbështetje e drejtpërdrejtë për shtetin e Kosovës. "Këtë projekt Qeveria e Kosovës e konsideron një nga projektet më madhore të vendit, pasi ka të bëjë me të dhëna dhe indikatorë shumë të rëndësishëm, në çdo fushë të jetës. Regjistrimi i popullsisë do të bëhet në tërë territorin Republikës së Kosovës në vitin 2021, prandaj ftoj të gjithë donatorët e pranishëm ta mbështesin këtë projekt madhor", ka thënë Hoxhaj.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka falënderuar donatorët e huaj, në veçanti EUROSTAT-in për ndihmën dhënë Agjencisë së Statistikave të Kosovës.





## Presidenti dekoron Loris Castriota Skanderbegun, Reto Nausen dhe Gjon Berishën

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të martën i ka dekoruar në ceremoni të ndara Loris Castriota Skanderbegun, Reto Nausen dhe Gjon Berishën me Medaljen e Dhjetëvjetorit të Pavarësisë.

Presidenti Thaçi i ka falënderuar ata për kontributin e dhënë për promovimin e Kosovës dhe për angazhimin e tyre për rua-

jtjen, kultivimin dhe promovimin e vlerave shqipe.

Pasardhësin e familjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Loris Castriota Skanderbegun, presidenti Thaçi e ka falënderuar për mishërimin me vlerat, traditat, historinë shqiptare dhe angazhimin e tij për ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e këtyre vlerave.

Kurse politikanit zviceran Reto Nausen i ka shprehur mirënjohje për kontributin për promovimin e Kosovës në Zvicër dhe për përkrahjen e dhënë për komunitetin e Kosovës atje. Ndërkaq veprimtarin Gjon Berisha e ka falënderuar për përkrahjen e përhershme në diasporë për të gjithë shqiptarët, nga të gjitha trojet shqiptare, para dhe pas luftës.



## Gjergj Kastrioti Skënderbeu mbetet figurë kryesore e identifikimit të popullit shqiptar

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 TETOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në hapjen e punimeve të konferencës shkencore ndërkombëtare "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes", e cila po mbahet në Prishtinë në kuadër të aktiviteteve "Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, 2018". Konferenca është organizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Institutin e Historisë në Tiranë dhe Institutin e Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve të Maqedonisë në Shkup dhe po mbahet në kuadër të aktiviteteve që po zhvillohen në gjithë hapësirën shqiptare.

Në këtë konferencë, përveç studiuesve dhe punonjësve

shkencorë shqiptarë, po marrin pjesë edhe punonjës shkencorë të Hungarisë, Anglisë dhe vendeve të tjera të botës. Ministri Bytyqi ka thënë se Gjergj Kastrioti Skënderbeu është një nga figurat më të respektuara në historinë tonë kombëtare. "Si figurë unifikuese, ai çdoherë ka qenë dhe mbetet adresa kryesore e identifikimit të popullit shqiptar. Skënderbeu, si një nga strategët më të njohur të artit luftarak, për 25 vjet rresht arriti të vë themelet e shtetit mesjetar shqiptar. Edhe përkundër që ai u ndesh me ushtrinë më të fortë të kohës, pra me atë osmane, për afër një gjysmë dekadë, ishte i pathyeshëm dhe pengesë kryesore që pengoi depërtimin e ushtrive osmane në Evropën Perëndimore", ka thënë Bytyqi. Ministri Bytyqi ka theksuar se Skënderbeu për vite të tëra shërbeu si figurë pikënisëse e shumë proceseve të mëdha të popullit tonë dhe, si i tillë, për shqiptarët e Kosovës ai ishte



shembulli më i mirë për vetëdijësimin e ndërgjegjes kombëtare. "Ai ishte udhërrëfyesi ynë në momentet më të rëndë-



sishme të ndërtimit të shtetit tonë, që nga vllimet e mëdha politike në fillimvitet '90 të shekullit të kaluar, më pas gjatë

luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e deri në ditët tona", ka thënë ministri Bytyqi.

## Ekipi i FSK-së fitoi medaljen e bronzë në garën e patrullimit "Cambrian Patrol"



PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht ekipi i përzgjedhur i FSK-së i udhëhequr nga togeri Behar Fazliu, oficer në Batalionin e Dytë të Reagimit të Shpejtë, arriti ta fitojë medaljen e bronzë në garën ndërkombëtare të patrullimit në Uells, garë kjo e rreptë dhe me konkurrencë të fortë prej 137 ekipeve, prej tyre 37 ekipe të ushtrive ndërkombëtare.

Të gjitha ekipet pjesëmarrëse në garë filluan realizimin e skenarit të stërvitjes nga data 12 tetor, duke u përballur me vështirësitë e mëdha të motit që shkaktoi stuhia "Cullum" edhe në zonën e garës patrulluese.

Në këtë garë ekipi i FSK-së përshkoi një sfidë lundrimi me gjatësi prej 80 kilometrash, përmes një sërë skenarësh të dizajnuar për ta testuar udhëheqjen, punën ekipore dhe durimin fizik dhe mendor të ekipit. Përveç

Republikës së Kosovës, në garën ndërkombëtare patrulluese në Mbretërinë e Bashkuar morën pjesë edhe ekipet e Forcave të Armatosura të vendeve të rajonit si ato nga Shqipëria, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

Ushtrimi "Cambrian Patrol" është një ngjarje vjetore e organizuar dhe e drejtuar nga Brigada e 160 e Këmbësorisë nga Uells, me seli në Breçon.

Ky ushtrim është unik, i nivelit botëror dhe më i madhi i këtij lloji, me pjesëmarrje edhe të shteteve të tjera që kanë të drejtë të marrin pjesë në Mbretërinë e Bashkuar, duke fituar nëpërmjet konkurrimit të tyre të brendshëm. Ushtrimi "Cambrian Patrol" teston të gjitha aftësitë themelore ushtarake të një ushtari të sotëm, duke rritur aftësinë e udhëheqjes dhe nivelet e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë.



Instituti GAP ka mbajtur tryezë diskutimi ku është prezantuar analiza "Zbatimi i MSA-së në nivel komunal - të arriturat dhe sfidat në shtatë komunat më të mëdha"

# MSA-ja zbatohet vetëm 12 për qind



Komunat e Kosovës kanë përmbushur 67 për qind të obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), por jo edhe niveli kombëtar, ku deri më tash ka përmbushur vetëm 12 për qind të obligimeve. Kështu u tha të martën në prezantimin e raportit "Zbatimi i MSA-së në nivel komunal - të arriturat dhe sfidat në shtatë komunat më të mëdha", të realizuar nga Instituti GAP

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 TETOR - Shumica e komunave nuk respektojnë Rregulloren e Zyrës së kryeministrit nr. 08/2011 për përgjegjësitë dhe kompetencat e nivelit lokal kundrejt agjendës integruese të vendit. Kështu është thënë në analizën e Institutit GAP "Zbatimi i MSA-së në nivel komunal - të arriturat dhe sfidat në shtatë komunat më të mëdha". Sipas kësaj analize, rregullorja specifikon se çdo komunë duhet të ketë zyrë dhe, së paku, një zyrtar i punësuar për integrimin evropian. Por në praktikë disa komuna kanë zyrë, disa kanë vetëm zyrtarë, disa të

tjera drejtori për integrim evropian.

Marrë në tërësi, sa i përket zbatimit të MSA-së nga niveli lokal, të arriturat më të mëdha janë saktësimi i obligimeve që i kanë komunat në këtë proces, themelimi dhe inkuadrimi i minoriteteve në këshillat për siguri në bashkësi, zbatimi i obligimeve ligjore në përdorimin e gjuhëve zyrtare, ndërmarrja e masave në mbrojtjen e të dhënave personale, evidentimi i shkallës së braktisjes së shkollës nga nxënësit, largimi i deponive të egra nga zonat e banuara, si dhe hartimi i planeve komunale në efikasitet të energjisë.

Ndërsa sfidat më të mëdha për përmbushjen e MSA-së nga niveli

lokal janë reforma e administratës publike në nivel lokal, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e tokës bujqësore dhe resurseve pyjore, zbatimi i rekomandimeve të auditorit si dhe mbrojtja e shëndetit publik. Bekim Salihu nga Instituti GAP, duke prezantuar raportin, ka pohuar se kanë gjetur që disa komuna kanë zyra për integrim evropian, disa komuna kanë vetëm zyrtarë për integrim evropian. "E shihni një strukturë bukur të çakorduar në nivelin lokal sa i përket çështjes së adresimit të integritimit evropian, ndonëse rregullorja kërkon që secila komunë duhet të ketë zyrë dhe jo drejtori, duhet të ketë zyrë dhe jo departament, duhet të ketë zyrë dhe jo zyrtar, zyrtarët për integrim evropian nuk janë të trajnuar për të aplikuar në fondet e IPE-së. Komuna kanë vështirësi dhe pamundësi për të përfituar nga këto fonde. Vitin e kaluar Kosova ka pasur në dispozicion nga fondet e IPE-së, 67 milionë euro, nga to janë përfituar 31 milionë dhe nga to asnjë nuk është përfituar nga komu-

nat", ka thënë ai.

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian, Blerta Deliu, ka thënë se MSA-ja është kontrata më serioze në mes të BE-së dhe Kosovës. "Ne jemi në një fazë tejet të rëndësishme dhe sfiduese, e dini që kohët e fundit Kuvendi është duke u përballë me një situatë jo shumë të mirë për shkak të pamundësisë që të miratohen ligjet për shkak të bllokadës nga ana e opozitës, e cila në një farë forme po jep sinjale jo të mira, jo vetëm në procesin e liberalizimit të vizave, por edhe në zbatimin e MSA-së sepse me të drejtë u përmenden një mori ligjesh të cilat ne duhet t'i përfundojnë si Kuvend për të përmblytur këtë proces dhe për të shënuar rezultate konkrete", ka thënë ajo. Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Integrim Evropian (MIE), Kushtrim Cukaj, ka vlerësuar raportin e Institutit GAP dhe ka premtuar se në koordinim me MAPL-në, do të merren seriozisht të gjitha rekomandimet e dala. Ai u zotua se MIE do të ndërmarrë aktivitete

konkrete ku dinamika e bashkëpunimit në mes të MIE-s dhe komunave do të ndryshojë shumë shpejt. Kurse sekretarja e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Rozafa Ukë-Imeraj, ka deklaruar se nga viti 2013 kanë identifikuar të gjitha obligimet që janë për komunat për MSA-në dhe tanimë çdo muaj kanë takime me përfaqësuesit e komunave për t'i identifikuar të gjitha obligimet që kanë komunat. "Në kriteret politike, komunat kanë arritur një performancë 70 për qind të implementimit në gjashtëmujorin e parë është fjala, në kriteret ekonomike 65 për qind dhe në standardet evropiane 65 për qind. Më duhet të them se në vitin 2017 detyrat e komunës nuk kanë qenë të përfshira në planin kombëtar të MSA-së, të cilin e raporton Ministria e Integritimit Evropian dhe, pavarësisht prej këtij rezultati inkurajues, që në total është 67 për qind, ne kemi të përmbushur në nivelin kombëtar vetëm 12 për qind të MSA-së deri në këtë moment", ka thënë Ukë-Imeraj.

## Hoti në Bruksel: Idetë për korigjimin e kufijve, të rrezikshme për paqen

BRUKSEL, 16 TETOR (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka marrë pjesë në konferencën e nivelit të lartë të Partive Popullore Evropiane në Parlamentin Evropian në Bruksel, e cila ka për synim t'i mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkim Evropian (BE). Në këtë konferencë Hoti, në panelin me temën "Rritja e bashkëpunimit ndërkufitar dhe trajtimi i çështjeve të sigurisë", ka shprehur qëndrimin e LDK-së në raport me zhvillimet në Kosovë dhe për perspektivën evropiane të vendit tonë. Hoti ka thënë se Qeveria e Kosovës, për shkak të koalicionit të dobët, e ka humbur shumicën në Kuvend dhe për këtë arsye ka humbur edhe

legjitimitetin për ta përfaqësuar popullin e Kosovës. "Kjo krizë institucionale dhe politike është thelluar veçanërisht që nga prilli i vitit 2018, kur një nga partitë e koalicionit, që përfaqëson bashkësinë serbe, 'ngriu' pozicionin e saj brenda Qeverisë. Megjithatë, sipas Kushtetutës së Kosovës, përfaqësuesit e komunitetit serb kanë vendet e tyre të garantuara", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se si rezultat i kësaj krize çështjet që janë me interes kombëtar nuk mund të adresohen. "Për të dalë nga kjo situatë, zgjedhjet e reja janë të nevojshme dhe të pashmangshme dhe se LDK-ja si partia më e madhe, është e vetëdijshme për përgjegjësinë që ka për ta kapërcyer këtë krizë institucionale", ka shkruar ai.

Hoti ka thënë se është në interesin e të gjithë qytetarëve të Kosovës që partitë politike të arrijnë konsensus lidhur me agjendën evropiane dhe përgatitjet për zgjedhje të reja dhe të lira. Më tutje, ai ka folur edhe për dialogun me Serbinë, duke thënë se LDK-ja e mbështet plotësisht dialogun me Serbinë, edhe pse është një proces shumë kompleks dhe se shumica e marrëveshjeve të arritura deri tani nuk janë zbatuar. "Çdo ide e shkëmbimit territorial ose korigjimit të kufijve nuk do të gjejë asnjë mbështetje dhe për këtë arsye nuk duhet të jetë pjesë e dialogut. Të gjitha partitë në Kosovë, duke përfshirë partitë e koalicionit, janë kundër kësaj ideje. LDK-ja beson fuqimisht se vizatimi i kufijve, bazuar në baza etnike,



është krejtësisht i gabuar dhe do të ketë pasoja përtej Ballkanit", ka shkruar ai.

Hoti ka thënë se idetë që përfshijnë ndryshimin e territorit dhe korigjimet kufitare janë të

rrezikshme për paqen në rajon dhe më gjerë dhe ato nuk duhet të merren parasysh sepse, sipas tij, ide të tilla kanë shkaktuar më parë konflikte në rajon, me pasoja tragjike.



# 'Përplasje' në Komisionin për Zhvillim Ekonomik për Ligjin për Automjete

Mbledhja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të martën është përcjell me përplasje ndërmjet opozitës dhe pozitës për shkak të mospajtimeve rreth Projektligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Automjete



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 TETOR - Deputetët opozitarë, Hykmete Bajrami nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Dardan Sejdiu nga Partia Socialdemokrate (PSD) si dhe Mimoza Kusari-Lila nga Alternativa, të cilët janë anëtarë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, kanë lëshuar të martën mbledhjen e këtij komisioni si shenjë kundërshtimi ndaj raportit me rekomandime rreth Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete.

Deputetja Kusari-Lila ka deklaruar se ky projektligj rrezikon gjendjen e mjedisit në Kosovë. "Duke marrë parasysh kundërshtimet që ky projektligj i sjell për mjedisin, ne nuk qendrojmë në takim për ta kaluar

këtë projektligj", ka thënë Kusari-Lila. Sipas deputetit të PDK-së, Memli Krasniqi, ky vendim i anëtarëve të opozitës ishte qesharak dhe i turpshëm. "Është më shumë se qesharak dhe i dobët që nuk ka të bëjë me interesat e opinionit publik. Le të tregojnë se çfarë kanë bërë për ambientin. Po flasim për dy ish-ministra. Çfarë kanë bërë për ta ulur ndotjen. Pra, kjo çfarë bënë sot është më shumë se humor dhe turp. Obligimi i tyre është për të votuar kundër. Duhet për t'ju ardhur marre", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj, e ka quajtur hipokrizi veprimin e deputetëve të opozitës. "Nuk mbaj mend a ka ardhur ndonjëherë Kusari-Lila. Opozita ka qenë dendur e përfshirë në këtë projektligj. Logjika që të votohet në komision ligji, pastaj të bojkotohet

seanca, mendoj se është më së paku hipokrizi", ka thënë Nitaj. Kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala, ka thënë se vendimet e deputetëve opozitarë janë për ponë politik. Edhe

përkundër bojkotit të opozitës, ky komision ka miratuar raportin me rekomandime për plotësim-ndryshimin e Projektligjit për Automjete.

Kuorumin pas largimit të opozitës e ka bërë deputeti Adem Hodza nga Lista Serbe.

Në mbledhjen e këtij komisioni

paraprakisht është miratuar raportin për Projektligjin për efikasitet të energjisë si dhe është vendosur që shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për kandidatët për kryesues të Bordit të ZRRE-së të hiqet nga rendi i ditës dhe t'i kthehet prapa Qeverisë.

## Prezantohet logoja e Agjencisë së Standardizimit

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala dhe Libor Chlad, zëvendësesh për bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, kanë prezantuar të martën logon e Agjencisë së Standardizimit (ASK)

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 TETOR - Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC), Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) dhe Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) kanë mbajtur aktivitet për Ditën Botërore të Standardeve. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala dhe Libor Chlad, zëvendësesh për bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, kanë prezantuar logon e Agjencisë Kosovare të Standardizimit (ASK). Me këtë rast ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se sfida mbetet mospërfshirja e certifikimit në Agjencinë e Standardizimit. "Unë kam nënshkruar udhëzimin administrativ për logon e Agjencisë Kosovare të Standardizimit si dokument që vendos rregullat e logos së agjencisë që do të jetë simbol i këtij organi standardizues. Sfidë mbetet mospërfshir-

ja e certifikimit në Agjencinë e Standardizimit me ç'rast standardizimi në Kosovë do të bëhet më i fuqishëm dhe në bazë evropiane do të implementoheshin në një masë më të lartë. Do ta mbështes AKS-në që ky shërbim t'u ofrohet institucioneve tona dhe le të fillojmë të krijojmë besimin në produktet tona", ka deklaruar Shala. Sipas tij, shitja e standardeve çdo vit është në rritje dhe se Kosova duhet të bëhet sa më konkurruese me shërbimet e veta.

Ministri Shala ka thënë se standardizimi në Kosovë është në rrugë të mbarë.

Kurse Libor Chlad, zëvendësesh për bashkëpunim në zyrën e BE-së në Kosovë, ka deklaruar se ky projekt është një revolucion i katërt industrial. "Ky është një projekt që fuqizon lëvizjen e lirë të mallrave dhe ky është një revolucion i katërt industrial dhe ka sjellë renovime mekanike", ka thënë Chlad, duke shtuar se standardet gjithmonë kanë mundësuar që ta rrisin zhvillim-

Following the redesign of the logo, the Project will focus on supporting activities on other corporate identity elements such as the mission statement and vision statement. These can be used when AKS decides to adopt a quality management system and/or diversify its services.



in e teknologjisë. Hafiz Gara, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Standardizimit, ka deklaruar se çdo vit shënojnë

këtë ditë për t'i promovuar arritjet. "Uroj që standardet e Kosovës të jenë sa më pranishme në bizneset e Kosovës, që

produktet tona të jenë sa më cilësore dhe prodhuesi kosovar të jetë sa më i pranishëm në treg", ka thënë Gara.



# Limaj zotohet se do të jetë zëdhënës i prodhuesve vendorë



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, në një bashkëbisedim me bizneset të organizuar nga Oda e Afarizmit të Kosovës, ka thënë të martën se do të jetë zëdhënës i prodhuesve vendorë. "Apeli im është që ta ndihmojmë prodhimin vendor. Duke ndihmuar prodhuesit vendorë e ndihmojmë shtetin", ka deklaruar Limaj

**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 TETOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se është koha e fundit kur duhet të ketë një pikënisje të ndërtimit të politikave të qarta ekonomike për vendin. Në një bashkëbisedim me bizneset të organizuar nga Oda e Afarizmit të Kosovës, Limaj ka kërkuar të martën më shumë frymëzim për vendin. Ai ka thënë se është koha e fundit kur të gjithë bashkë, prodhues dhe tregtarë, duhet ta shohin Kosovën si atdheun e tyre. Limaj ka shtuar se duhet të ndalet njëherë e përgjithmonë sjellja hipokrite e disa njerëzve të cilët synojnë vetëm t'i mashtrojnë njerëzit.

Limaj e ka thënë hapur se nuk mund të rrënohen biznese të tëra në mbrojtje të një kompanie. Ai ka kërkuar nga bizneset që para se të kërkojnë ndihmë nga Qeveria duhet t'i kryejnë obligimet ndaj punëtorëve. Ndërsa u ka kërkuar bizneseve që të mos heqin dorë nga presioni ndaj Qeverisë për të ndërmarrë veprime të cilat janë në funksion të fuqizimit të ekonomisë së vendit.

Zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se institucionet që mbrojnë interesat e bizneseve vendore duhet të jenë pjesë përbërës e hartimit të politikave ekonomike në vendin tonë. Ai ka thënë se nga dita e parë e angazhimit të tij ka qenë i fokusuar që prodhimi vendor dhe lufta për hapje të

vendeve të punës do të jenë prioritetet kryesore të Qeverisë si parakusht që krijon efekt të mirëqenies, zhvillim dhe ngritje të standardit të njerëzve tanë. "Ne respektojmë dhe jemi pjesë e një tregu të madh dhe interesi strategjik i vendit është integrimi në BE, me ekonomi të tregut, me konkurrencë dhe me kushte të barabarta. Jo ekonomi të tregut ku s'ka konkurrencë ose ka konkurrencë të egër që shkatërron ekonominë e vendit. Mungesa e një rregullativi të qartë ligjor dhe mungesa e vetëdijes dhe dashurisë për këtë vend na ka sjellë në situata ku prodhimi vendor është ekspozuar në një konkurrencë të pabarabartë", ka thënë Limaj. Ai ka shtuar se mungesa e një

kujdesi institucional në kushte të barabarta praktikisht ka sjellë pasoja dhe rezultate jo të kënaqshme. Sipas Limajt, Kosovës i duhet tregtia dhe prodhimi vendor dhe në asnjë mënyrë nuk duhet parë që politika e Kosovës është për një sektor. Ai ka bërë apel që secili ta kryejë punën e vet. "Ne po përpiqemi t'i thjeshtojmë procedurat burokratike. Të kthehemi ta bëjmë një kornizë ligjore ekonomike e cila është në shërbim të fuqizimit të ekonomisë së vendit dhe duke respektuar

marrëveshjet ndërkombëtare që kemi. Kosova të mos lejohet të përdoret si oazë ku mund të shitet gjithçka pa konkurrencë dhe bizneset tona të kenë barrierë në vendet fqinje", ka shtuar Limaj.

Ai u ka thënë bizneseve që para se të kërkojnë nga shteti ata duhet t'i kryejnë obligimet që kanë ndaj punëtorëve. "Apeli im është që ta ndihmojmë prodhimin vendor. Duke ndihmuar prodhuesit vendorë e ndihmojmë shtetin", ka deklaruar Limaj.

## OAK-u kërkon që lehonat të paguhen 100 për qind nga shteti

Në këtë takim u ngre edhe çështja e punësimit, ngritja e pagave dhe çështja e lehonisë. U tha se me ligjin aktual, TVSh-ja dhe pushimi i lehonisë është në dëm të jashtëzakonshëm të biznesit. Përfaqësues të Odës së Afarizmit të Kosovës kanë kërkuar që lehonat të paguhen 100 për qind nga shteti.



## Administrata e Gjilanit ka përmbyllur 96 për qind të lëndëve

**GJILAN, 16 TETOR (ER)** - Në nëntëmujorin janar - shtator 2018, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në Gjilan ka realizuar lëndët si të përfunduara me një përqindje të kënaqshme prej 96 përqindësh. Kështu ka bërë me dije, në një konferencë për medie, drejtori i kësaj administrate, Bardhyl Sylja, duke shtuar se në fokus të veçantë ka qenë ngritja e nivelit të performancës për shërbime sa më cilësore dhe sa më transparente në raport me qytetarët. "Kemi bërë riorganizim të brendshëm dhe jemi në konsolidim të mëtutjeshëm të sektorit të gjendjes civile në aspektin e zbatimit të detyrave

punuese nga zyrtarët, duke krijuar lehtësira teknike administrative gjatë kryerjes së shërbimeve ndaj qytetarëve. Me këtë riorganizim kemi arritur ta evitojmë bredhjen e qytetarëve prej një sporteli në sportelin tjetër", ka thënë Sylja. Ai ka theksuar se ka rënie të kilometrave të kaluara të automjeteve të komunës si dhe të shpenzimeve në karburante në krahasim me vitin 2017. "Gjatë vitit 2017 kilometra të kaluara kanë qenë 206 232 kilometra, krahasuar me nëntëmujorin e këtij viti me 164 861 kilometra, që i bie 41 371 më pak kilometra të kaluara", është shprehur Sylja.



## MMPH-ja financon rregullimin e lumit 'Klina' në Skenderaj

**SKENDERAJ, 16 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, dhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, kanë përfunduar fillimin e punimeve për ndërtimin e shtratit të lumit "Klina", tek ura afër Shërbimit të Zjarrfikësve, e cila ka një gjatësi prej 530 metrash në drejtim të fshatit Llaushë. Jashari ka thënë se është prioritet i qeverisjes lokale në

Skenderaj rregullimi i tërësisht i shtratit të këtij lumi. "Jam thellësisht i lumtur për realizim të këtij projekti, pasi më nuk do të ketë vërshime nga të cilat më së shumti kanë vuajtur banorët e lagjeve përgjatë shtratit të lumit 'Klina'. Ky është vetëm fillimi i finalizimit të shtratit të lumit në gjithë gjatësinë e tij", ka thënë Jashari. Ai ka shtuar se viti 2019 do të fillojë me investime më të

mëdha në projekte në infrastrukturë rrugore, bujqësi, në sistemin e kanalizimit e ujësjellësit, projekte sportive, kulturore dhe fusha të tjera. Ndërsa ministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi, ka thënë se për këtë projekt kjo ministri ka ndarë 200 mijë euro. Ai ka bërë me dije se në këtë vit MMPH-ja do ta mbështesë Skenderajn edhe në katër projekte të tjera në një shumë rreth një milion euro.



## Prizreni do të jetë pjesë e projekteve zhvillimore

**Prishtinë, 16 tetor (ER)** - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, ka pritur në takim punë të martën kryetarin e Prizrenit, Mytahir Haskuka. Gjatë këtij takimi Llluka ka siguruar Haskukën se Prizreni do të jetë pjesë e projekteve strategjike zhvillimore të cilat do të ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve të Prizrenit. Llluka dhe Haskuka kanë diskutuar edhe për projektet që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet për qytetarët siç janë ai për traj-

timin e mbeturinave, përmirësimin e furnizimit me ujë të pijes, trajtimin e ujërave të zeza, ngrohtoren e qytetit, Parkun e Biznesit dhe Parkun për Inovacion dhe Trajnime. "Ne po punojmë intensivisht që të mbulojmë me ngrrohtore qendrore qytetin e Prizrenit. Kjo jo vetëm se përmirëson ajrin dhe stabilitetin energjetik në komunën tuaj, por dukshëm përmirëson kualitetin e jetës për qytetarët e Prizrenit. Kemi në fokus përmirësimin e rrjetit të

ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës suaj si dhe realizimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza", ka thënë Llluka. Ndërsa kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka kërkuar mbështetje nga ministri Llluka për realizimin e projektit të Parkut të Biznesit. "Për komunën tonë është jetike funksionalizimi i projektit për krijimin e Parkut të Biznesit, i cili ende nuk është finalizuar për shkak të procedurave administrative", ka thënë Haskuka.

## Asfaltohen tri rrugë në Lloshkobare të Ferizajt

**Ferizaj, 16 tetor (ER)** - Kushtet e përshtatshme atmosferike kanë mundësuar realizimin e projekteve të ndryshme infrastrukturore në Komunën e Ferizajt. Një projekt i tillë është duke u realizuar në fshatin Lloshkobare. Në këtë fshat janë asfaltuar tri rrugë, përkatësisht rruga "Selman Selmani", "Musli Selmani" dhe "Shkalla e Tafës". Për të parë punimet që po kryhen në këto rrugë ka dalë kryetari i Ferizajt, Agim Aliu dhe drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Aliu ka vlerësuar investimet në zonën rurale si të

rëndësishme së veçantë për zhvillimin e përgjithshëm të këtyre pjesëve. Ndërsa drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, ka thënë se në këtë projekt po bëhen investime të cilësishme së lartë dhe sipas standardeve më të larta të infrastrukturës rrugore. Projekti në tërësi përfshin asfaltimin e 10 rrugicave në fshatin Lloshkobare dhe kanë një kosto prej 220 mijë eurosh. Me këtë projekt përmbyllet investimet kryesore infrastrukturore në fshatin Lloshkobare, përkatësisht asfaltimi i rrugicave në këtë fshat.





# NJË TAKIM I PAZAKONTË DIPLOMATIK QË BËRI JEHONË BOTËRORE

(Hajdin Abazi, "Takimi në Junik", AAB, 2018)

## Bashkim RRAHMANI

Është shumë vështirë të përzgjedhësh gjëra që duhen thënë për një person të shquar dhe për një libër të shkëlqyer e para një auditori të rëndësishëm. Sidoqoftë, iu nënshtrova kësaj sfide dhe po filloj me një dialog nga një vepër e Jose Rizalit.

"Qe sa kohë keni që jeni larg nga vendi?" e pyet Laruja Ibaran.

"Qe gati shtatë vjet".

"Atëherë, me gjasë, paskeni harruar gjithçka rreth atdheut".

"Është krejt e kundërta. Madje, edhe po të dukej se vendi im më ka harruar krejtësisht, unë gjithmonë do të mendoj për të". / Jose Rizal, Noli Me Tangere


E vendi nuk është se e kishte harruar mikun dhe kolegun tim Lum Haxhiu dhe Hajdin Abazi. Rrethanat e kishin detyruar të largohej fizikisht nga vendi, por jo edhe me mendje, me shpirt e me zemër. Dhe largimi nuk ishte i përhershëm. Pak vjet pas largimit fizik, Lumi do të kthehet në vendin e vet. Tashmë jo me poezi, jo me shkrime dhe jo me takime, por me tërë qenien e tij duke rrokur armët në luftë për lirinë e vendit të vet.

U ktheva nga një ndër udhëtimet e shumta nga ShBA në prill të vitit 1998, në një kohë kur vendi po sulmohej ashpër nga pushteti okupator i asaj kohe. Në vija të frontit po zhvilloheshin beteja të ashpra në të cilat Lumi ishte me armë në dorë. Lumi, pra, ishte me forcat e UÇK-së, të cilat po bënin të pamundurën për liri dhe për mbrojtje të të pambrojturve. Tashmë UÇK-ja po njihet si guerilë e ushtri që ishte ngritur në mbrojtje të vendit, ndërkohë që Serbia nga dëshpërimi i humbjeve ushtarake dhe diplomatike, UÇK-në e quante terroriste. E këta djem e vajza, këta burra e gra, ishin nisur nën moton: "Ky është atdheu ynë, jeta jonë dhe me që ne nuk e kemi edhe një atdhe, ne do të luftojmë për të deri në fund

dhe nuk do të heqim dorë kurrë" (Viktor Orban). E në mesin e këtyre burrave dhe grave nuk ishin vetëm ushtarët e thjeshtë. Aty ishin edhe mësuesit, mjekët, poetët, diplomatët, profesorët dhe kështu me radhë. Dhe kjo përbërje në rritje të vazhdueshme bëri që UÇK-ja të bëhej faktor që nuk mund të mos merrej si i tillë në përpjekjet për pushimin e luftës dhe vënien e paqes në Kosovë.

Në këto rrethana, unë isha në një mënyrë aktiv në politikë si sekretar i Degës së LDK-së në Gjakovë përderisa kishte vite që punoja për një organizatë mjaft me ndikim në Uashington, të cilën e përfaqësoja në regjion. Kjo bënte që të isha pak a shumë në rrjedhë të informatave, të cilat i merrja qoftë këtu duke qenë i angazhuar, por edhe duke pasur rastin të udhëtoja nëpër shtete dhe vende të ndryshme.

Kisha ndjekur vizitën e z. Richard Holbrooke në Kosovë në fillim të verës së vitit 1998 dhe sidomos vizitën e tij në Junik. Dhe sigurisht mua, dhe të gjithë neve që ishim pjesë e asaj bote, na kujtohen paraqitjet filmike të takimit të z. Holbrooke me Lumin dhe të tjerët në një odë të Junikut. Ato pamje filmike dhe ato fotografi me shpejtësi zunë emisionet qendrore të stacioneve televizive dhe faqet kryesore të gazetave prestigjioze në botë. Është shkruar shumë për këtë takim të rëndësishëm, për çka unë nuk do flas më shumë. Por do t'i them edhe disa fjalë, se çka më kishte thënë z. Holbrooke për takimin e Junikut dhe për Lumin, pak kohë më vonë, në Nju Jork. Ndërkohë që Lumi po vazhdonte të qëndronte në vija të frontit dhe krahas të qëndruarit në front e kryente edhe një mision po aq të rëndësishëm duke informuar publikun për luftën dhe sukseset e pasojat e shkaktuara. E kisha të njohur emrin e Hajdin Abazit si aktivist për liri. Gjatë kohës së luftës po e



njihja virtualisht më për së afërmi. E fotografia nga Oda e Junikut ishte objekt i bisedave formale e joformale në takime që i kisha brenda dhe jashtë vendit.

Kështu në fund të verës së vitit 1998, në një restorant, pronar i të cilit ishte një aktivist i dalluar i çështjes kombëtare, z. Bruno Selimaj, personalitete të shquara nga Këshilli Kombëtar Shqiptaro Amerikan u mblodhën në një takim joformal me Ambasadorin Holbrooke. Në këtë takim po merrja pjesë personalisht. Biseduam për shumë çështje që kishin të bënin me gjendjen në Kosovë por edhe me angazhimin diplomatik lidhur me Kosovën. U fol edhe për shqetësimet që dilnin nga të mos qenurit unik të faktorit shqiptar në Kosovë. Lidhur me mosunifikimin e faktorit shqiptar z. Holbrooke ishte shprehur në këtë takim dhe kjo është reflektuar edhe në librin e Lumit dhe Hajdinit në faqen 93 e 94.

Por ajo që dua të vë sot në pah, është ajo që z. Holbrooke më kishte thënë gjatë një pauze të këtij takimi të gjatë në Nju Jork lidhur me takimin e Junikut dhe për mikun dhe kolegun tim Lum dhe Hajdin. Citoj: "...Në një situatë të ndërlikuar ushtarake dhe politike, u takova në një odë të Junikut me përfaqësues të UÇK-

së dhe drejtpërdrejt bisedova me ata. Kishte pajtime dhe mospajtime. Kishte gjëra që i kuptoja dhe kishte gjëra që pak me vështirësi i kuptoja. Megjithatë i kuptoja dhe shumë më bënte përshtypje përkushtimi i tyre për luftën dhe për paqen... Njëri nga ata ishte një i ardhur nga Skandinavia, më duket. Ishte i butë dhe të jepte përshtypje të ishte largpamës dhe ishte racional në mendime dhe në veprime.

Ai kishte ardhur të luftonte dhe kjo të jep qartë të kuptosh se kishte ardhur edhe të jepte jetën. Kjo ishte e qartë... Të jesh racional në vlerësime dhe në vendime në rrethana të tilla nuk është e lehtë... Është më shumë se e vështirë.

Ai nuk mbivlerësonte fuqinë e forcave të veta dhe nuk nënvlerësonte fuqinë e forcave kundërshtarë... ishte i qetë, i shkurtër në fjalë por i thellë në mendime. Kishte përgjigje për rrethanat me maturi të duhur dhe ishte njeri me të cilin mund të bisedohet për marrëveshje të qëndrueshme... në një kohë të shkurtë dhe në rrethana të tilla edhe takimi i shkurtër të jep të kuptosh shumë gjëra. Ishte për t'u admiruar përballja e njerëzve si kjo e djalit që kishte ardhur nga Skandinavia, me mua dhe bisedat për paqen dhe për lirinë që këta njerëz e donin për popullin e tyre. Lumi dhe shokët e tij po tregonin atë që mendonin se duhej treguar në rrethana të tilla e unë po i shikoja dhe po i dëgjoja me kureshtje nga pozita e një zyrtari të një shteti, të cilit ata i besonin më së shumti dhe tek i cili shpresonin më së shumti. Jo rrallë e kam kujtuar takimin me Lumin dhe me shokët e tij dhe siç po e sheh edhe këtu po të them se është për t'u admiruar vullneti i tij, për t'u kthyer në vendin e tij të lindjes, kur para së gjithash mund të jepje jetën... po e di mirë se çka më kishte thënë Lumi dhe çka dëshironte Lumi... prandaj jam këtu sonte edhe me juve, edhe pse

jozyrtarisht në takim...", mbaron citati.

E thashë në fillim se e kam të vështirë të përzgjedh momente të veçanta për t'i përmendur sot para jush, sepse secili moment është më i rëndësishëm se tjetri. Megjithatë dua të veçoj diçka që, krahas botimit të librit, është me rëndësi të theksohet. Lumi e nxjerr librin 20 vjet pas ngjarjes dhe nuk ngarend të bëjë historinë me turravrap. Është për t'u çmuar modestia e tij, por Lumi duhet ta dijë se ai është i njohur pavarësisht prej modestisë edhe për atë kohë të lavdishme sikundër që është i njohur edhe për këtë kohë kur Lumi po jep kontributin e vet, natyrisht tash në një mënyrë tjetër. Kur e shikojmë Hajdin Abazin, shokun dhe kolegun tim dhe tuaj patjetër se duhet marrë thënien e Herbert Hoover që shkante si vijon: "vendi im nuk më ka kurrfarë borxhi. Ai më ka dhënë mua, sikurse çdo djali a vajze një shans. Ai më dha shkollimin, pavarësinë për të vepruar, mundësinë për shërbim dhëndër".

E Lumi duket se këtë thënie e ka si një lloj maksime udhëzuese për veten. Ka kohë që punojmë bashkë dhe gjatë punës e shoqërimin, me Lumin flasim e diskutojmë për të sotmen dhe të ardhmen. Gjithherë i hapur në debat, i sqartë, i artikullar politikisht me precizitet gjeometrik, i avancuar në aspektin akademik, i papërtuar për të qenë i angazhuar, i gatshëm për të ndihmuar, i dashur për studentët dhe për të rrumbullakuar, Lumi ka qenë dhe është trim i mirë me shokë shumë. Ndihem i privilegjuar dhe shumë i nderuar që u përzgjedha që të jam një ndër recensentët e librit të Lumit të cilin po e promovojmë sot. Faleminderit miku im! Faleminderit Kolegjit AAB që botoi një libër me vlerë shumë të çmuar! Faleminderit edhe juve që më dëgjuat! Shëndet dhe suksese për Lumin dhe për të gjithë Ju!

## Poterqi i Klinës me rrugë të asfaltuara

Klinë, 16 tetor (ER) - Ministri i Infrastrukturrës, Pal Lekaj, bashkë me ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, dhe kryetarin e Klinës, Zenun Elezaj, kanë përfunduar rrugët e asfaltuara të fshatit Poterq dhe fillimin e punimeve në fshatin Gjurgjevik i Madh. Rrugët e fshatit Poterq kanë gjatësi mbi 6 kilometra dhe janë realizuar me mbështetjen e plotë të Ministrisë së Infrastrukturrës. Projekti i rrugës së Gjurgjevikut të Madh, me gjatësi prej 4 kilo-

metrash, do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe komunën e Klinës. Ministri Lekaj ka thënë se Ministria e Infrastrukturrës po e mban premtimin e dhënë banorëve të Poterqit para një viti, se ky fshat do të bëhet me infrastrukturë moderne.

Kurse për fillimin e punimeve në rrugën e Gjurgjevikut të Madh, ministri Lekaj, duke e falënderuar MFSK-në për mbështetjen për realizimin e këtij projekti me rëndësi për

banorët, ka thënë se kjo mbështetje e FSK-së, që së shpejti do të shndërrohet në ushtri të vendit, po e dëshmon se është në shërbim të të gjithë qytetarëve krahas ofrimit të sigurisë për territorin e Kosovës.

Ministri MFSK-së, Rustem Berisha, ka thënë se mbështetja e MFSK-së në këtë projekt për banorët e Gjurgjevikut është dëshmia më e mirë se FSK-ja është e të gjithëve dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit.



Kurse kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka falënderuar ministrin Lekaj dhe ministrin Berisha për

mbështetjen e vazhdueshme dhe të parrezervë dhënë komunave në tërë vendin, në këtë rast Komunës së Klinës.



**E rrallë**

# Parku me skulptura mizore në Tajlandë

Tajlanda njihet si vend që tërheq shumë turistë, si dhe për parqet e ndryshme të argëtimit që ka, me tema nga më të ndryshmet. Por, një park në këtë vend është me skulptura mizore i quajtur "Kopshti i Ferrit", në të cilin ka skulptura aq të frikshme sa pamjet konsiderohen të rënda për



shumë njerëz. Por, këto detaje vetëm sa e kanë shtuar numrin e vizitorëve.

## BARSOLETA E DITËS



**Burri:** Ish rit çmimi i gazit sot.  
**Gruaja:** Ani çka ka lidhje, ti veturë nuk ke.  
**Burri:** E çka që nuk kam veturë. E kam shkrepësen.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### “ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

**Rolet:** Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
**Regjia:** Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### “JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
**Regjia:** David Kerr



Në ora 18:00

#### “NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
**Regjia:** Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### “SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
**Regjia:** Matthew Ross



Në ora 22:00

#### “VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
**Regjia:** Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

### FOTO E DITES



Punëtorët e shpëtimit dhe ushtarët ecin në qytetin Villegailhenc të Francës pas përmbytjeve. /AP/

### E jashtëzakonshme

## Akullorja me uthull

Në Kinë uthulla përdoret në shumë gatime, por një dyqan në këtë shtet ka ofruar në diçka më të pazakontë: në akullore. Ky dyqan ndodhet në Tajuan, që njihet si vendi ku ka origjinën një lloj uthulle shumë e famshme në Kinë, e quajtur Lao Çen Su. Përbërësit e tjerë të akullores janë po aq të çuditshëm. Veç qumështit, sigurisht, dyqani i shton shije bizelesh, elbi, melekuqeje dhe, në fund, uthullën e famshme.



#### DASHI

Dita sot do të jetë plot ngjyra të ndezura ashtu si edhe stina. Do të jeni në një klimë mjaft të mirë bashkëpunimi me kolegët.



#### DEMI

Jeni mjaft dyshues sot në lidhje me një raport të ri miqësor por, falë përvojës që keni, do të dini të zgjidhni çdo të papritur.



#### BINJAKËT

Hëna në shenjë ju bën mjaft pozitiv sot. Marrëdhënie të sinqerta dhe korrekte nga të gjithë personat pjesëmarrës parashikon dita sot.



#### GAFORRJA

Jeni në sintoni të plotë me njerëzit tuaj të dashur dhe dëshirat e idetë e tyre janë edhe tuajat. Kjo gjë do t'ju ndihmojë të zgjidhni çdo problem që ju del përpara.



#### LUANI

Mund të veproni kur e shikoni që situata po del jashtë kontrollit, por nëse ju nuk jeni pjesë e saj, nuk keni pse ekspozoheni për keq te njerëz të caktuar.



#### VIRGJËRSHA

Edhe pse jeni në mbyllje të një projekti të rëndësishëm, ju keni filluar projekte të reja që do t'ju shoqërojnë gjatë kohës së lirë. Jeni të entuziazmuar për gjërat që priten.



#### PESHORJA

Dita sot do të jetë e mbushur me ngjarje dhe situata që në shumë çaste do t'ju nervozojnë. Nuk po menaxhoni dot të gjithë ngarkesën që keni në familje dhe në punë.



#### AKREPI

Sot mes fantazisë dhe realitetit ka një ndryshim të madh. Duhet ta gjeni ekuilibrin ndërmjet të dyjave që të mund të kënaqeni nga të gjitha gjërat.



#### SHIGJETARI

Edhe pse keni shumë mbështetje nga miqtë tuaj sot, nuk do të mund t'i bëni ballë një situatë të ndërlikuar që do të çojë në përplasje dhe debate të ashpra.



#### BRICJAPI

Edhe pse shumë gjëra nuk po shkojnë siç shpresonit, do të mund të vendosni rend në organizimin e ditës suaj dhe, si rrjedhojë, edhe të punëve të mbetura përgjysmë.



#### UJORI

Kjo periudhë e vitit do të sjellë ndryshime jo dhe aq të dukshme në pamje të parë, por që do të jenë thelbësore për ju. Nëse keni marrë një vendim, mos u ktheni pas.



#### PESHQIT

Jeni të ndjeshëm sot dhe prekeni edhe nga gjëra të vogla, por partneri është gjithmonë pranë jush për t'ju rikthyer humorin dhe pozitivitetin që ju karakterizon.



Intervistë me Marigona Krasniqi, autore e romanit "Zëri i mbytur i gruas"

# Marigona Krasniqi sjell romanin 'Zëri i mbytur i gruas'

Pas përmbledhjes poetike "Trëndafili kërkon shi", Marigona Krasniqi nga Drenasi ka sjellë para lexuesve romanin "Zëri i mbytur i gruas". Ky roman sjell një rrëfim real të një të mbijetuare nga dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë

**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**Prishtinë, 16 tetor** - Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", autorja e romanit "Zëri i mbytur i gruas", Marigona Krasniqi, ka thënë se ky roman ka qenë kërkesë e lexuesve. "Romani është rrëfim real i një të mbijetuare nga dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë. Sigurisht nuk ka qenë punë e lehtë. Sidomos pjesa më e vështirë ka qenë menaxhimi emocional gjatë përshkrimit të historisë së të mbijetuarës", ka thënë Krasniqi.

Për këtë roman dhe librin e parë poetik, Marigona nuk ka gjetur mbështetje as komunale dhe as nga institucionet e tjera të nivelit qendror. Marigona Krasniqi, pos që merret me krijimtari letrare, është duke studiuar edhe në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". "Ndonëse angazhimet e mia në Fakultetin e Mjekësisë janë të mëdha, shkrimin e kam pasion dhe përderisa më ka dhënë Zoti këtë dhunti, e ndiej obligim moral të shkruaj për të mirën e shoqërisë sonë. Unë flas si qytetare femër. Nuk jam mësuar të hesht. Forca ime ndod-

mëdha, shkrimin e kam pasion dhe përderisa më ka dhënë Zoti këtë dhunti, e ndiej obligim moral të shkruaj për të mirën e shoqërisë sonë. Unë flas si qytetare femër. Nuk jam mësuar të hesht. Forca ime ndodhet kudo, në fjalë, në roman apo edhe në fizik. Sepse të jesh femër nuk është dobësi. Shkrimi i romanit ka qenë kërkesë e lexuesve. Ndoshta jo të shumë në numër, por lexuesit e shkrimeve të mia janë tejet aktivë, me këshilla, kritika dhe sugjerime. Dhe kur nxora librin e parë "Trëndafili kërkon shi", që ishte përmbledhje poetike, ata kërkuan t'u sjell edhe një roman. Gjithashtu, më kritikuan përse nuk e kam shtjelluar më tepër temën e luftës së fundit në Kosovë. Kjo pastaj bëri që unë t'i përvishem punës me shumë përkushtim.

**"Epoka e re":** Romani "Zëri i mbytur i gruas" është botuar vetëm disa ditë më herët. Sa jeni e kënaqur me punën e bërë në të dhe si është pritur?

**Marigona Krasniqi:** Për shkak të tematikës shumë delikate të romanit unë jam munduar të derdh gjithë energjinë time në të. I kam kushtuar rëndësi të madhe



këtij romani?

**Marigona Krasniqi:** Po, romani është rrëfim real i një të mbijetuare nga dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë. Sigurisht nuk ka qenë punë e lehtë. Sidomos pjesa më e vështirë ka qenë menaxhimi emocional gjatë përshkrimit të historisë së të mbijetuarës. Unë sikurse çdo njeri tek i cili është ende e pranishme njerëzoria, përfjetojta ngushtim në shpirt dhe pikëllim në zemër teksa i imagjinoja femrat e ndershme të Kosovës të jenë pjesë e një horrori të tillë. Por, mendoj se secila e mbijetuar duhet të flasë me dikë, ta tregojë historinë e vet të kobshme, e që është veç një hallkë në zinxhirin e gjatë të vuajtjeve të popullit tonë. Dhe secili qytetar duhet të njoftohet mbi zvetënimin dhe përcudnimin që dikur iu bë atyre femrave. Dhe nisur nga kjo, unë i thirrja vetes që të përmbahem mirë emocionalisht sepse pena ime duhet të fliste. Kështu ia dola. Por, përveç kësaj teme, në romanin tim inkorporohen edhe tema të tjera si, p. sh., paragjykimi, dashuria për familje dhe atdhedashuria, sfidat e studentëve gjatë studimeve etj. Në

këtë roman u kam dhënë rëndësi edhe bukurive natyrore të Kosovës.

**"Epoka e re":** A keni pasur përkrahje për botimin e këtij romani nga dikush?

**Marigona Krasniqi:** Nga askush. Edhe këtë libër, si të parin, i kam vetëfinancuar. Nuk e di për të tjerët, por unë për vete nuk kam gjetur mbështetje as komunale dhe as institucionale për financimin e këtyre dy projekteve të mia. Por, më duhet të falënderoj shumë Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, drejtoreshën Feride Rushiti dhe Sebahate Pacolli-Krasniqi nga kjo qendër, që i kanë dhënë shpirt romanit tim, duke më mundësuar të rrefej ngjarjen e njëres nga të mbijetuarat së dhunës seksuale.

**"Epoka e re":** Sa kohë ju ka marrë deri në botim?

**Marigona Krasniqi:** Romanin e kam filluar në fillim të muajit shkurt të këtij viti dhe e kam mbaruar në fund të shtatorit. Ndërsa më intensivisht kam punuar me të gjatë pushimeve të

verës. Pjesa kryesore e romanit është bërë në muajt e fundit, kryesisht pas intervistës me viktimën. Përjetimet e viktimës jam munduar t'i bashkëjetoj dhe t'i bashkëndiejë dhe si rezultat i kësaj kjo pjesë e romanit ka dalë shumë prekëse e që nuk kalohet lehtë pa dhimbje e lot.

**"Epoka e re":** Jeni studente e mjekësisë. A do të vazhdoni edhe më tutje të shkruani romane, dhe a keni menduar të shkruani ndonjë libër nga lami i mjekësisë?

**Marigona Krasniqi:** Në paçim shëndetin gjithsesi që do të vazhdoj të shkruaj romane por do të shkruaj edhe zhanre të tjera të letërsisë. Ndërsa të shkruaj ndonjë libër nga lëmi i mjekësisë është edhe ëndrra ime më e madhe. Por, vlerësoj se këtë duhet ta bëj vetëm pasi të arrij grada të larta akademike dhe pasi të jem shumë e kalitur në profesion. Diçka konkrete nuk kam në mendje, por sigurisht se duke parë situatat e reja me të cilat përballemi çdo ditë, lindin edhe idetë e reja për punë të tjera.

**"Epoka e re":** Pas këtij romani, çfarë do t'u sillni lexuesve?

**Marigona Krasniqi:** Lexuesve do t'u sjell gjithçka që unë e vlerësoj se është më e mira për ta. Me anë të pendës sime do të përpiqem gjithmonë t'i ngrah lart virtytet e mira të shoqërisë dhe t'i luftoj dukuritë e dëmshme. Sepse vlerësoj që është e nevojshme të shkruajmë sa më shumë për vlerat dhe të mos anashkalojmë edhe temat edukuese, në mënyrë që të mos pësojmë krizë morali si shoqëri. Sigurisht do të ketë edhe romane të tjera, pastaj poezi, regjime dhe, pse jo, edhe drama



het kudo, në fjalë, në roman dhe në fizik", ka thënë Krasniqi. Marigona ka thënë se do të vazhdojë të shkruajë romane. "Do të shkruaj edhe në zhanre të tjera të letërsisë. Të shkruaj ndonjë libër nga lëmi i mjekësisë është ëndrra ime më e madhe", është shprehur autorja e romanit "Zëri i mbytur i gruas", Marigona Krasniqi.

**"Epoka e re":** Znj. Krasniqi, jeni studente e Fakultetit të Mjekësisë. Kush ju frymëzoi për të shkruar roman?

**Marigona Krasniqi:** Fillimisht ju falënderoj për intervistën. Është kënaqësi për mua të ndaj me ju dhe lexuesit tuaj përvojat e mia gjatë punimit të romanit. Ndonëse angazhimet e mia në Fakultetin e Mjekësisë janë të

çdo detaji vetëm që t'i afrohet sa më shumë të përkryerës. Dhe pas një angazhimi të tillë, të gjatë e serioz, unë jam shumë e kënaqur me përfundimin e këtij projekti. Populli ynë i ka ende plagët e hapura, e plagët e hapura shkaktojnë shumë dhimbje. Dhe njerëzit i ka prekur shumë kjo temë. Për fillim është pritur mjaft mirë. Lexuesit e kanë vlerësuar shumë që një vajzë në moshën time ka marrë guximin të shtjellojë një temë kaq të ndjeshme dhe të vështirë. Ndërsa për suksesin e librit më tutje mbetet të shihet.

**"Epoka e re":** Na tregoni pak më shumë për këtë roman, pasi tema e tij prek një ngjarje të vërtetë. Sa e keni pasur të vështirë të arrini në përfundimin dhe botimin e





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SANTANDER - UD LOGRONES

1-1

REAL ZARAGOZA - CADIZ

3+

THE NEW SAINTS - LLANDUDNO

1&amp;4+

# Derbi kuqezi i takon Drenicës. 89-shi, bindës ndaj Lirisë

KF Drenica dhe KF Trepça '89 kanë shënuar fitore bindëse si mysafirë të Flamurtarit dhe të Lirisë, kurse dy ndeshje të tjera të kësaj xhiroje zhvillohen sot dhe përballen Drita - Ballkani dhe Llapi - Gjilani

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 TETOR - Skuadra e Drenicës dhe ajo e Trepçës '89 të martën kanë shënuar fitore bindëse si mysafirë të Flamurtarit dhe të Lirisë. Befasia e madhe e këtij edicioni në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Flamurtari, ka dëshpëruar tifozët e vet, pasi ka humbur bindshëm ndeshjen ndaj Drenicës (0-3). Ndeshja në mes dy skuadrave kuqezi i ka takuar xhiros së dhjetë në elitë, kurse është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet. Mesfushori me përvojë të madhe në skuadrën nga Skenderaj, Taulant Dajaku, e hapi serinë e golave në minutën e 21-të. Pesë minuta më vonë rezultatin e dyfishoi Kreshnik Uka. Golin e tretë dhe të fundit për Drenicën në këtë ndeshje e realizoi mesfushori Diar Mustafa në minutën e fundit të pjesës së parë. Në pjesën e dytë, pavarësisht prej tentimeve të Flamurtarit që të rikthehet në lojë, gola nuk pati dhe ndeshja përfundoi 0-3. Të martën fitore bindëse shënoi edhe skuadra e Trepçës '89, e cila luajti si mysafirë e Lirisë në Prizren. 89-shi



shënoi fitore me rezultat 0-4. Pjesa e parë ishte e barabartë dhe u mbyll pa gola, kurse dy minuta pasi filloi pjesë e dytë Martin Mircevski i kaloi mysafirët në epërsi 0-1. Pesë minuta para fundit Arian Muja shënoi për 0-2, kurse në minutat shtesë dy golat e tjerë i shënuan Hasan Hyseni dhe Orges Gava. Dy ndeshje të tjera të xhiros së nëntë zhvillohen të mërkurën.

Në Gjilan, Drita si kampione në fuqi e pret skuadrën e Ballkanit, kurse në stadi-

umin "Zahir Pajaziti" në Podujevë zhvillohet ndeshja në mes të Llapit dhe Gjilanit. Kjo është ndeshja e parë për Llapin pas shkarkimit të Bylbyl Sokolit dhe largimit të kryetarit Nexhat Dumnica. Ndërsa Komisioni i Garave i IPKO Superligës, me kërkesë të klubeve, ka vendosur që dy ndeshjet e javës së 9: Feronikeli - Prishtina dhe KEK-u - Ferizaj të shtyhen për 7 nëntor për shkak të angazhimit të lojtarëve të këtyre klubeve me ekipet përfaqësuese.

## Prishtina për fitore ndaj Cherkaskit

"Jemi përgatitur mirë me trajnerin e ri që ka ardhur. Kemi ushtruar intensivisht. Lëndime nuk kemi dhe të gjithë lojtarët janë gati të japin 100 përqindëshin. Ekipi i Ukrainës është shumë i fortë dhe luan fizikisht, prandaj kjo do të jetë një ndeshje e fortë. Ftoj 'Plisat' dhe shikuesit që të jenë në numër sa më të madhtë na përkrahin, pasi është ndeshje e rëndësishme", ka thënë Dardan Berisha

EPOKA E RE

Liridon ZEQRIRI

PRISHTINË, 16 TETOR - Z Mobile Prishtina sonte (e mërkurë) do ta luajë ndeshjen e parë të këtij edicioni në FIBA Europe Cup. Trajneri i ri i kryeqytetasve, Damir Mulaomerović, ka thënë të martën, në një konferencë për medie, se skuadrën e kryeqytetit të Kosovës e pret një punë e vështirë, pasi Cherkaski Mavpy është një kundërshtar shumë i fortë. "Të gjithë e dimë se skuadra ukrainase është e mirë, por lojtarët tanë kanë stërvitur shumë mirë gjatë këtyre 7-8 ditëve të fundit dhe besoj se do të japim gjithçka nga vetja për të arritur rezultat. Kundërshtari ynë është ekip shumë atletik. Nuk do të jetë lehtë, por besoj në këtë ekip dhe kemi punuar shumë për këtë ndeshje", ka thënë trajneri Mulaomerović.

Në konferencë për medie ishte i pranishëm edhe kapiteni i Prishtinës,



Dardan Berisha, i cili ka ftuar "Plisa"-t dhe shikuesit të jenë në numër sa më të madh për ta përkrahur skuadrën kryeqytetase drejt fitores. "Jemi përgatitur mirë me trajnerin e ri që ka ardhur, duke ushtruar në mënyrë intensive. Lëndime nuk kemi dhe të gjithë lojtarët janë gati ta japin 100-përqindëshin. Ekipi i Ukrainës është shumë i fortë dhe luan

fizikisht, prandaj kjo do të jetë një ndeshje e fortë. Ftoj 'Plisat' dhe shikuesit që të jenë në numër sa më të madh të na përkrahin, pasi është ndeshje e rëndësishme", ka thënë Berisha. Në grup me Prishtinën dhe Cherkaski Mavpy e Ukrainës janë edhe Bakken Bears nga Danimarka dhe Steaua nga Rumania.

SHKURT

### Haxhi Krasniqi më 17 nëntor sfidon gjermanin Stefan Haertel

Boksieri më i suksesshëm shqiptar, Robin Haxhi Krasniqi, më 17 nëntor 2018 do të rikthehet në ring për ta mbrojtur titullin EBU të Evropës, të fituar më 2 qershor 2018. Përballë Krasniqit në "Anhalt-Arena" të qytetit gjerman Dessau do të jetë boksieri i talentuar gjerman Stefan Haertel, i cili si amator ka arritur suksese të mëdha dhe ka qenë pjesëmarrës në Lojërat Olimprike. Stefan Haertel është 30-vjeçar dhe e mban rekordin 17-1-0. Ai është konkurrent i Robin Krasniqit në të njëjtin klub promovues, në SES BOXING, aktualisht klubi më i fuqishëm gjerman. Për Krasniqin ky do të jetë dueli i 54-t profesionist. Deri tani Krasniqi ka siguruar 48 fitore dhe ka fituar shumë trofe ndërkombëtarë, ka luftuar dy herë për titullin e botës, është shpallur dy herë kampion evropian dhe në bazë të këtyre statistikave është boksieri më i suksesshëm shqiptar.

### Sadiku, e argjendte në turneun "Balkan"

Boksierja e Kosovës, Donjeta Sadiku, ka fituar medaljen e argjendte në turneun ndërkombëtar "Balkan" të mbajtur në Botevgrad të Bullgarisë. Sadiku në finale u mposht nga braziliana Gomez Gleisiele, në kategorinë deri në 64 kilogramë. Sadiku me këtë turne tregoi formë të mirë para Kampionatit Botëror që mbahet në Indi.

### Khaka, lojtar i ndeshjes Islandë - Zvicër

Zvicra e ka mposhtur Islandën me rezultat 1-2, kurse nga vlerësimet e bëra pas përfundimit të ndeshjes në bazë të performancës së ekipeve në fushën e blertë, ekipi zviceran ka marrë notën 6.99, ndërsa skuadra vendëse është vlerësuar me 6.61. Pas harkimit të bukur të Granit Xhakës në zonë, topi ka përfunduar te Seferović, i cili ka realizuar golin e parë me kokë. Ky asistim ka lehtësuar punën e vlerësuesve të cilët e kanë shpallur shqiptarin lojtarin më të mirë të ndeshjes. Mesfushorit i është vënë nota 8.2, ndërsa Xherdan Shaqirrit 7.6.

### Shqipëria U19 e mbyll me humbje

Kombëtarja U-19 e Shqipërisë ka luajtur ndeshjen e fundit zyrtare të turneut për U-19. Skuadra e drejtuar nga trajneri Erion Bogdani ka luajtur kundër Norvegjisë, nga e cila është mundur me rezultat 0-1. Këto janë eliminatorët e dyta pa marrë asnjë pikë, madje pa shënuar asnjë gol në tre ndeshje zyrtare. Erik Bothein (31) shënoi golin e fitores për norvegjezët. Norvegjia dhe Ukraina kualifikohen për në "Elite Round".



## Humbin Kosova U21 dhe U19

PRISHTINË, 16 TETOR - Kosova e grupmoshave U21 është mposhtur nga Izraeli me rezultat 3 me 0. Djelmohat e Rafet Prekazit u mposhtën në ndeshjen e zhvilluar në Tel Aviv dhe

me këtë humbje Kosova është e parafundit në grupin kualifikues për Evropianin U21. Kosova tubon 14 pikë në pozitën e pestë, ndërsa grupit i prin Gjermania me 25 pikë, e

ndjekur nga Norvegjia me 14 pikë. Përfaqësuesja e Kosovës U19 pësoi humbje sot nga Sllovenia me rezultat 1-4 dhe në këtë mënyrë ka mbyllur kualifikimet për Kampionatin

Evropian në rrethin e parë. Golin e nderit për Kosovën e shënoi Gentrin Limani, kurse për Slloveninë tre gola i realizoi Aljosa Matko dhe një tjetër e shtoi Nik Prelec.



# 'Stobi Flips', sponsor gjeneral i kategorive të reja në basketboll

PRISHTINË, 16 TETOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) dhe kompania "Vitaminka" sot kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, ku "Stobi Flips" do të jetë sponsor gjeneral i të gjitha ligave të kategorive të reja, në të dyja konkurrencat. Marrëveshja njëvjeçare është nënshkruar në zyrë të FBK-së nga përfaqësuesi i kompanisë "Vitaminka", Luan Ajeti dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku. "Stobi Flips" ka qenë sponsor gjeneral i Përfaqësueses U18 të Kosovës dhe FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, që është mbajtur në fund të muajit korrik në Prishtinë dhe ashtu si ne, edhe kompania "Vitaminka" jemi ndarë të kënaqur me mënyrën e bashkëpunimit, andaj kemi vendosur të gjejmë një tjetër mënyrë për të vazhduar këtë bashkëpunim, dhe kështu kemi vendosur bashkërisht që 'Stobi Flips' të jetë marka që të do t'i mbështesë të gjitha ligat e kategorive të reja në të dyja konkurrencat. Për ne



është nder dhe kënaqësi që ligat tona të bartin si parashtesë emrin e një marke të fortë siç është 'Stobi Flips', ka thënë Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së. Ndërsa përfaqësuesi i kompanisë "Vitaminka", Luan Ajeti, ka deklaruar: "Për ne është shumë e rëndësishme që të vazhdojmë ta përkrahim rininë tonë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, andaj kemi vendosur

